

Instituti Albanologjik i Prishtinës, VAJTIME, GJAMË DHE ELEGJI, përgatitur nga Anton Çetta dhe Dr. Anton Berisha, Prishtinë, 1987.

Vëllimi *Vajtime, gjamë dhe elegji*, botimi i Institutit Albanologjik të Prishtinës, përgatitur nga punonjësit shkencorë Anton Çetta dhe Anton Berisha, përshin një material të pasur nga këto lloje të lirikës gojore. Atij i prin një studim me titull *Mbi vajtimet shqiptare*, ku vështrohen disa nga tiparet e rëndësishme të këtij lloji mjaft të përhapur e të kultivuar ndërshqiptarë. Ato studiohen si krijime që heqin gjurmë qysh nga kohët kur njeriu u bë i vetëdijshëm për vetveten.

Elemente të vajtimeve, sipas këtij studimi, hasen qysh në burimet më të hershme letrare të shkruara, si në *Epin e Gilgameshit*, në *Iliadë*, në krijimet lirike dhe epike të letërsisë sonë gojore dhe të popujve të tjerë etj.

Rëndësia e studimit qëndron në faktin se vajtimet trajtohen si krijime letrare gojore që përbëjnë një lloj më vete në tërësinë e krijimtarisë gojore shqiptare e që janë të lidhura me ritet dhe kanë elemente qysh nga religjionet e lashta, si, për shembull, ai pagan e të tjera.

Në studim theksohet se vajtimet janë krijime që lindin në momentin e caktuar, në kushte të caktuara dhe i kushtohen një individi, çka do të thotë se cilësohen me dukurinë e improvizimit. Megjithatë, ato janë të mbrojtura me elemente të lashta të poezisë sonë gojore të krijuara gjatë shekujsh dhe të ruajtura në traditën tonë letrare gojore.

Studimi i vajtimeve në aspektin e zhvillimit historik që nga të dhënat e para me shkrim, të Barleti e këndej, na japin të kuptojmë se kemi një traditë të pasur të krijimtarisë letrare gojore, që e dëshmojnë edhe format e ndryshme të këtyre krijimeve të paraqitura si vajtime të mirëfillta, ose si elemente vajtimesh brenda llojeve të tjera të poezisë gojore.

Vajtimet, pra, janë forma letrare që, përveç tjerash, janë edhe shprehje e kushteve socio-historike dhe kulturore e sidomos ato që u kushtohen personaliteteve të shquara,

njerëzve që kanë humbur jetën tragjikisht për ideale kombëtare etj.

Që nga kapitulli i parë, në të cilin bëhet fjalë për vajtimet në përgjithësi, shihet se është studiuar problematika gradualisht, duke u nisur që nga format e para të paraqitjes së elementeve të hershme dhe primitive të vajit, i cili ishte shprehur nëpërmjet klithjeve dhe britmës e deri te vajtimet e mirëfillta. Lashtësia e tyre që nga kohët e hershme theksohet nëpërmjet literaturës së pasur të popujve të ndryshëm, për të gjetur pastaj elemente të vajtimeve në veprat më të lashta e deri në ditët e sotme. Kjo pjesë u ofron lexuesve, sidomos atyre që merren me studimin e kësaj problematike, një pasqyrë të pasur të studimeve të kësaj fushe.

Në kapitullin që bëhet fjalë për interesimin dhe studimin e vajtimeve, shihet se janë hulumtuar disa burime të shkruara, në të cilat në mënyrë të tërthortë ose të drejtpërdrejtë trajtojnë çështje të ndryshme që dëshmojnë për ekzistimin e vajtimeve si krijime të lashta të letërsisë gojore shqipe që nga Barleti, Budi, Bardhi, etj. Pastaj vihen në pah përmbledhjet tona të ndryshme të hershme në të cilat ka të dhëna (direkte ose indirekte) për vajtimet dhe për studiuesit tanë e të huaj, që kanë shprehur mendime për to. Në vazhden e përmbledhjeve dhe të studimeve përmenden: francezi La Guilletiere, Fjalori i Katalanos, Dorëshkrimi i Kieutit, Charles Didier, Biondelli, V. Dorsa, J. G. Von Hahni, Elena Gjika, Zef Jubani, V. Stratikoi, M. Markiano, L. Gurakuqi, V. Prennushi, M. Lambertzi, A. Sirdani, E. Cabej, F. Fishta, K. Gurakuqi, Dh. Shuteriqi, Z. Sako, Rr. Zojzi e të tjerë. Këtu bëhet fjalë për kontributin që kanë dhënë ata, qoftë si mbledhës, pra shënues të vajtimeve, qoftë si studiues.

Në pjesën e tretë, që titullohet *Vajtimet e grave dhe gjamët e burrave*, mendojmë se me të drejtë është bërë ndarja në vajtime dhe gjamë, për arsye se ndryshojnë nga vetë mënyra e të vajtuarit e pjesë-

rishit edhe për nga struktura e tyre. Kjo pjesë është shumë e pasur me mënyren e prezentimit të vajtimeve si dhe për format e vajtimeve të lidhura me ritin e vdekjes. Bëhet fjalë sidomos për mënyrat e vajtimeve si nga burrat ashtu edhe nga gratë si dhe për disa forma të vajtit dhe të gjamës, të cilat shquhen me mënyrën e vajtimeve dhe të riteve të lashta që mund të konsiderohen si gjurmë të formave të flijimit përndive pagane (shih spërkatjen e të vdekurit me gjakun e gjamëtarit). Prezentimi i mënyrave të vajtimeve dhe të riteve që e shoqërojnë këta është bërë me sukses. Vëmendje përqendrohet në punkte të ndryshme, ku mënyra e vajtimeve është njëra prej karakteristikeve për të parë përsëritjet prej krabinës në krabinë, që dëshmojnë për pasurinë e traditës së vajtimeve. Në këtë pjesë flitet edhe për traditën e vajtimeve në diasporën e Greqisë.

Duke trajtuar botën tematiko-motivore të vajtimeve, konstatohet se tematika e tyre është shumë e pasur dhe lidhet me jetën në përgjithësi, me preokupimet e njeriut që nga ekzistimi i tij. Këtu veçohen aspektet më të rëndësishme të kësaj tematike që gjejnë trajtim në vajtime. Duke trajtuar vdekjen, gjamëtarit ose vajtorja e lidh atë me çështje e probleme jetësore, me çështje morale etj. Që vdekja të kapërcehet më lehtë krijuesi-ekzistuesi trajton çështje të lidhura me personalitetin e të vdekurit, me vetitë e tij të mira. Përveç virtyteve personale, vajtorja ose gjamëtarit rreh edhe çështje që lidhen me familjen, me vëllazërinë, me fisin, me rrethin shoqëror, në ç'mënyrë zgjerohet tematika e vajtimeve duke u marrë edhe me çështje gjithnjëzore.

Kapitulli *Struktura tekstore dhe vlerat artistike* është pjesë e vëllimshme e këtij punimi hyrës. Sig u thekua edhe më parë, edhe pse synohet studimi kompleks i vajtimeve, vëmendja përqendrohet në vlerën artistike të tyre, si komponentë e rëndësishme e tyre. Pas analizës së strukturës tekstore, vajtimeve kategorizohen në tri grupe. Në të parin hyjnë vajtimeve me strukturë tekstore të mirëfilltë, në të dy-

tin ato që nuk kanë strukturë koherente, ku teksti poetik nuk është elementi kryesor, ndërsa në të tretin hyjnë ato vajtime që kanë elemente të tipit të parë dhe të dytë.

Në këtë kapitull hetohen në mënyrë të theksuar vlerat artistike të vajtimeve, të cilat bëjnë që krijimi të realizohet si tërësi tekstore dhe poetike. Njëpërmjet shembujsh konkretë flitet për vlerat artistike të shprehura me anë të gjuhës poetike dhe të pasur me metafora, krahasime, simbole etj. Vlera e vajtimeve shihet edhe njëpërmjet përshkrimeve të realizuara me mjesh-tëri, njëpërmjet tablove të pasura etj. Të gjitha këto elemente shprehen edhe në kuptimësinë e pasur të këtyre krijimeve si dhe në fuqinë e përgjithësimin të dukurive. Shumë shembuj të cituar janë vërtet shembuj antologjikë dhe mund të radhiten ndër pjesët më cilësore të llojit të vet, por edhe të poezisë gojore në përgjithësi.

Në kapitullin *Mbi këngën e parë vajshme ose mbi elegjinë*, trajtohen çështje të elegjisë, duke e përcaktuar atë si formë letrare që gjendet në mes të vajtimeve dhe të këngës, së mirëfilltë lirike. Vëhet në dukje se kjo formë letrare ka lindur si nevojë e të shprehurit artistik në rastet e humbjes ose vdekjes së personit të dashur. Në rastin kur krijuesi këtë nuk e shprehte njëpërmjet vajtimeve, qoftë për hir të distancës kohore apo edhe për hir të nevojës së të shprehurit artistik, atëherë e krijonte elegjinë. Në studim vajtimeve shqyrtohen në mënyrë komplekse në raport me format e tjera të poezisë gojore lirike dhe epike, pastaj prania e vajtimeve në format e tjera të krijimeve të poezisë gojore, qoftë si tematikë, qoftë si strukturë tekstore. Ekzistimi i vajtimeve hetohet në disa lloje të lirikës si: në këngët e mërgimit, në këngët e dasmës e të tjera, po ashtu në krijimet epike, sidomos në ciklin e këngëve të kreshnikëve ku brenda këngës kreshnike koekzistojnë edhe vajtime të mirëfillta.

Trajtimi i vajtimeve brenda llojeve të tjera të lirikës dhe të epikës micon disa çështje të rëndësishme që lidhen me gjenezën e disa lloje.

ve letrare, si dhe me vetë faktin se vështirë mund të gjenden lloje të pastra të mirëfillta. Këtë e dëshmojnë edhe elementet e tjera të hetuara si, bie fjala, sistemi formulativ dhe ekzistimi i formulave në vajtime dhe përdorimi i tyre i suksesshëm në struktrën e llojeve të tjera.

Shikuar në tërësi, studimi mbi vajtimet shqiptare përfshin elementet qenësore të vajtimeve, pa u zgjatur në përshkrime ose detalizime të panevojshme. Pas leximit të punimit fitohen njohuri për këtë lloj të poezisë sonë gojore, për ekzistimin e vajtimit si dukuri dhe si formë letrare në krahina të ndryshme ku jetojnë shqiptarët, për disa veçori regjionale dhe kombëtare, për vlerat kuptimore, artistike, për tematikën e pasur për ekzistimin dhe bashkëjetesën e vajtimeve brenda llojeve të tjera etj.

Materialet e këtij vëllimi janë ndarë në tri pjesë. Në të parën janë përfshirë 74 vajtime, në të dytën 50 gjamë, ndërsa në të tretën 49 elegji. Nga kjo shihet qartë se në të është përfshirë një material i pasur me vajtime, gjamë dhe elegji nga viset e ndryshme të Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë si dhe të viseve të tjera, ku jetojnë shqiptarët në Jugosllavi.

Nga ndarja që është bërë vërehet se dy grupet e para (vajtimet dhe gjamët) janë klasifikuar sipas ekzistuesve të tyre, ndërsa i treti (elegjitë) si lloj më vete.

Grupi i parë *Vajtime* përfshin krijimet që ekzekutohen nga krijueset-vajtoret femra. Kjo pjesë është më e vëllimshmja për nga sasia, meqenëse vajtimi i grave, si dukuri, është i shtrirë pothuaj në të gjitha viset ku jetojnë shqiptarët. Në disa vise vajtimet i bëjnë gratë, të cilat njihen si vajtoresh gjysmë profesionale dhe profesionale e që shquhen me aftësitë e tyre krijuese. Mirëpo në disa vise vajtimet nuk i bëjnë vajtoresh profesionale; ato bëhen nga të afërmit e të vdekurit. Pjesa e parë, përmban vajtime të shënuara në shumë krahina etnografike të Kosovës, pastaj në Mal të Zi, Maqedoni etj. Edhe pse janë krijime që shquhen me elementin e improvizimit, meqë i kushtohen aty për aty

një personi të caktuar, ato megjithatë, kanë vlera të caktuara artistike dhe krijohen mbi bazën e traditës lirike ose epike, në ç'mënyrë dëshmohet edhe lashtësia e tyre.

Vajtimet në përgjithësi shquhen me tonin e tyre melankolik, me ndiesinë e hollë lirike, por edhe me veçori epike. Disa sosh madje kanë karakter të theksuar të krijimeve epike, si për narracionin e tyre të theksuar, për tipizmin e personit të cilin e vajtojnë, për zgjatjen e herpashershme, për përshkrimet epike etj. Ka në mesin e tyre vajtime që mund të radhiten jo vetëm ndër vajtimet më të mira brenda llojit, por edhe asosh që mund të hyjnë në antologji të krijimeve të poezisë gojore shqipe.

Nga materialet e këtij vëllimi shihet se vajtimi është një ndër format letrare të traditës sonë letrare gojore që heq gjurmë që nga kohët e mugëta të ekzistimit të njeriut. Këtë e dëshmojnë elementet e shumta të mitologjisë së lashtë popullore si dhe ritet e shumta të lashta si mbijetoja të besimit pagan. Po ashtu shihet se vajtimet nuk janë ekzekutuar vetëm me rastin e ditës së varrimit të të vdekurit, por ato janë praktikuar edhe një kohë të shkurtër ose të gjatë pas varrimit të personit. Këtë e shohim, bie fjala, tek ato që janë shënuar në Maqedoni, ku vajtimi nuk bëhet vetëm ditën kur varroset i vdekuri, por një javë, e herë-herë më shumë, duke u ekzekutuar pandërprerë nga të gjitha të afërmit e të vdekurit. (Kjo traditë ka qenë edhe në Pejë e në Gjakovë brenda në qytet, ku ditën e parë kanë vajtuar vajtoresh e pastaj në ditët e tjera kanë vajtuar femrat e shtëpisë si edhe vajtorja).

Disa nga vajtimet e përfshira në këtë vëllim dëshmojnë për aftësinë krijuese-poetike të vajtoreshve. Në vajtimin që i kushtohet personit të caktuar trajtojnë jetën dhe personalitetin e tij, dhëmbjen për ndarjen e përjetëshme nga të afërmit, ku herë pas here përdorin elemente formulative që mund t'i aplikojnë në shumë sish, mirëpo ato, me aftësinë e tyre krijuese, po ashtu thurin vargje të tëra me vlerë të duk-

shme artistike kuptimore. Shquhen sidomos vajtimet e vajtove Macë Sokolja, Razë Mushakja, Mare Gjonja Gjonaj, e të tjera, që dëshmojnë aftësitë e krijuesve të mirëfillta të vajtimeve.

Krijimet e këtij bleni kanë rëndësinë e tyre edhe për atë se lidhen me rite të caktuara (kanë funksion të dyfishtë, atë artistik dhe praktik). Në to trajtohet artistikisht jo vetëm jeta e të vdekurit, por edhe e familjes, fshatit e më gjerë.

Pjesa e dytë, siç u tha, përbëhet prej gjamësh, të cilat praktikohen sidomos në viset e veriut, në Malësi të Shkodrës, në Mirëditë, në Shalë, në Kelmend, në Grudë, në Hot, në Anë të Malit etj. Këtu janë përfshirë 50 gjamë të ekzekutuar nga gjamëtarë të ndryshëm. Ato shquhen sidomos me karakterin e tyre epik; ka në mesin e tyre krijime që rrahin çështje të ndryshme dhe mund të radhiten krah për krah me krijime të mirëfillta epike. Këtë e imponon vetë mënyra e vajtimit-gjamës e lidhur me rituale të lashta ku marrin pjesë anëtarë të ndryshëm të fiseve dhe bajraqeve, që pranë të vdekurit madhërojnë personalitetin e tij, familjen, fisin, kombin, ngjarjet e rëndësishme të periudhave të ndryshme historike shoqërore etj. Meqë janë ekzekutuar nga pjesëtarë të fiseve dhe të viseve të ndryshme (kuptohet kur ka vdekur ndonjë personalitet i shquar), ato janë shfrytëzuar që gjatë ekzekutimit të ndikojnë në anëtarët e bajraqeve dhe të fiseve që t'i harrojnë interesat e tyre të ngushta dhe të shohin interesin e përgjithshëm. Nëpërmjet madhërimit të personalitetit të të vdekurit madhërohen edhe vetët e pozitive si: burrëria, trimëria, mbajtja e besës etj. Të gjitha këto veçori nuk shprehen në mënyrë deklarative me një fjalor të thjeshtë, por thuhet me shprehje dhe fjalor relativisht të pasur, të cilat krijojnë mbresë dhe nguliten thellë

në vetëdijen e dëgjuesit-marrësit (tani dhe të lexuesit). Po ashtu edhe këtu shquhen disa gjamëtarë si krijues të mirë, të cilët, me gjamët e tyre e kanë pasuruar fondin e krijimeve të këtij lloji dhe të krijimtarisë sonë letrare në përgjithësi.

Pjesa e tretë *Elegji* përmban 49 krijime, dhe, me sa dimë, kjo është hera e parë që ky lloj letrar i lirikës sonë gojore botohet i sistemuar në një vëllim. Elegjitë janë shënuar në vise të ndryshme dhe nga krijues dhe bartës të ndryshëm. Në mesin e tyre gjenden disa sosh që shquhen me vlera letrare artistike. Ka dhe krijime që kanë lindur në kohë të vona. Ato ende nuk e kanë kaluar „cenzurën preventive të mjedisit” dhe shquhen me detaje të shumta. Fitohet përshtypja se ato janë fiksuar në fazën fillestare të lindjes. Nga materialet e prezentuara shihet qartë se populli ynë shumë dukuri të jetës i ka përcjellë me rite e i ka shoqëruar me këngë, dhe në këtë mënyrë e ka pasuruar jetën e tij shpirtërore. Vajtimet dhe gjamët dëshmojnë se edhe vdekjes, si akt më i dhembshur në jetën e njeriut, i është kushtuar kujdes nga krijuesi ynë gojor. Këto materiale, përveç tjerash, do t'u shërbejnë studiusve jo vetëm për njohjen e këtyre llojeve, por edhe për krahasimin e tyre me llojet e tjera të letërsisë gojore shqiptare si dhe me krijimet e ngjashme të popujve të tjerë.

Tërë ky material i begatshëm i zgjedhur dhe i sistemuar dëshmon për punën e bërë me njohuri dhe me kritere shkencore.

Në fund të blenit është dhënë edhe aparatura përcjellëse: fjalori i fjalëve të rralla, lista e vajtove, gjemëtarëve dhe e këngëtarëve të elegjive, lista e mbledhësve dhe pasqyra e lëndës.

MYZAFERE MUSTAFA

Instituti Albanologjik
Prishtinë